



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.738/20
747/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të : Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “El-Bau & Eing Com” SH.P.K dhe OE “Efa Dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë”, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Aroma Plus” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan-Ritender” me nr. të prokurimit: 941-20-2219-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Universiteti Publik Kadri Zeka Gjilan”, më datën: 05.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “El-Bau & Eing Com” SH.P.K. dhe OE “Efa Dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë”, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan-Ritender” me nr. të prokurimit: 941-20-2219-2-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Universiteti Publik Kadri Zeka Gjilan”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan-Ritender” me nr. të prokurimit: 941-20-2219-2-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Universiteti Publik Kadri Zeka Gjilan”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “El-Bau & Eing Com” SH.P.K- dhe OE: “Efa Dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë”, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SY ET IM

Operatorët ekonomik ankues “El-Bau & Eing Com” SH.P.K. dhe OE “Efa Dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë”, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 01.10.2020, me nr. 738/20, dhe me 01.10.2020 me nr. 747/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Aroma Plus” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan-Ritender” me nr. të prokurimit: 941-20-2219-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Universiteti Publik Kadri Zeka Gjilan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 par.1.2, nenin 6 par.1, nenin 7 par.1.2.4, nenin 51 par. 1, nenin 56 par.1.1 ,1.2 dhe par. 3, nenin 59 par. 4 i LPP-së, dhe neni 41 pika 3 e RRUOPP-së, te ankesa me nr. 738/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 27, 59, 60, si dhe nenin 61 të LPP-së te ankesa me nr. 747/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “El-Bau & Eing Com” SH.P.K.

Pretendimi nr. 1 i OE ankues

Arsyeja nr. 1 e eliminimit të OE ankuesit në Letrën standarde është: “Ofertës tuaj i mungon ISO Certifikata OHSAS 18001-2007, për veprimtarin adekuate siç është kërkuar ne dosjen e tenderit për siguri dhe pastrim te hapësirave te brendshme ju keni prezantuar, ISO OHSAS 18001-2007 për ndërtim te larte dhe te ulet.

Përgjigja e ankuesit tek arsyeje nr. 1 : më dt. 01.07.2020, keni kërkuar sqarime lidhur me këtë pike dhe ne ju kemi përgjigjur si në vijim : Lidhur me piken 1. . Ju Njoftojmë se grupi I OE ka plotësuar këtë pike duke ofruar certifikatën ISO 45001:2018 Pasi qe certifikata OHSAS 18001:2007 është zëvendësuar me ISO 45001:2018 për arsye se certifikatat OHSAS 18001:2007 do të jene te vlefshme deri 10.03.2021 dhe nuk do të këtë me trup certifikuese OHSAS 18001:2007 por do të kaloje ne ISO 45001:2018 për këtë ju ofrojmë edhe deklaratën informative nga trupa certifikuese.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë sqaron, se në ofertën e GOE ankuesit "EL-Bau &Eing Com"SH.P.K janë të bashkangjitura tek oferta Certifikatat, ku OE ka sqaruar se Certifikata OHSAS 18001:2007 është zëvendësuar me ISO 45001:2008, dhe po ashtu tutje Eksperti sqaron se në E-prokurim edhe disa OE të tjerë kanë dhënë shpjegime për këtë certifikatë, mirëpo mbetet nën kompetencë të AK-së që të verifikoj këtë Certifikatë nga Autoritetet Kompetente, andaj ky pretendim i OE ankuesit gjendet pjesërisht i bazuar.

Zertifikat Certificate

Quality Management System

Certificate No: 1020ERQ

For: EL BAU SHPK

Address: LIMON STANECI, GJILAN, REPUBLIC OF KOSOVO

Assessment Scope: Low general construction and infrastructure, concrete with concrete products, electrical installation with maintenance, maintenance of public spaces, public buildings with technical and hygienic maintenance

International Standard: ISO 9001:2015, Quality Management System

Issue: 01, Certification date: 05 June 2020
Date of issue of the certificate: 05.06.2020
Date of validity of the certificate: 04.06.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project contract: 14.05.2020
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com QMTUV 1020Q
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

 EBS
QMS ISO 9001:2015



Kettenhofweg 1, 60325 Frankfurt am Main, Germany

www.ebsgmbh.com

ISO 45001:2018 transition information for clients

The new standard ISO 45001 was published on 12 March 2018. With this release, OHSAS 18001:2007 will be withdrawn, maximum expiration date of OHSAS 18001:2007 certificates will be 10.03.2021. Companies certified to the OHSAS 18001:2007 standard have to transition their certificate to ISO 45001:2018.

We inform you with this letter that OHSAS 18001:2007 is equivalent to ISO 45001:2018 until 10.03.2021.

Kind Regards,

Quality Manager
M. Collaku

Zertifikat

Certificate

Occupational Health and Safety
Management System

Certificate No: 1020ERO

For: EL BAU SHPK

Address: LIMON STANECI, GJILAN, REPUBLIC OF KOSOVO

Assessment Scope: Low general construction and infrastructure, concrete with concrete products, electrical installation with maintenance, maintenance of public spaces, public buildings with technical and hygienic maintenance.

International Standard: ISO 45001:2018, Occupational Health and Safety Management System

Issue: 01, Certification date: 05 June 2020
Date of issue of the certificate: 05.06.2020
Date of validity of the certificate: 04.06.2021Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 14.05.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit. The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuanceCertificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/10200
Offices: EBS + Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem
OHSAS ISO 45001:2018

Authorized Signature:



Zertifikat

Certificate

Environmental Management System

Certificate No: 1020ERE

For: EL BAU SHPK

Address: LIMON STANECI, GJILAN, REPUBLIC OF KOSOVO

Assessment Scope: Low general construction and infrastructure, concrete with concrete products, electrical installation with maintenance, maintenance of public spaces, public buildings with technical and hygienic maintenance.

International Standard: ISO 14001:2015, Environmental Management System

Issue: 01, Certification date: 05 June 2020
Date of issue of the certificate: 05.06.2020
Date of validity of the certificate: 04.06.2021Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 14.05.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit. The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuanceCertificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1020E
Offices: EBS + Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem
EMS ISO 14001:2015

Authorized Signature:



Pretendimi nr. 2 i OE ankues:

Arsyeja nr. 2 e eliminimit të OE ankuesit:

Ne aspektin tekniko-profesional është kërkuar nga AK se OE pjesëmarrës ne këtë tender duhet te ofroj kontrata te natyrës se ngjashme, ju ne ofertën tuaj keni prezantuar një kontrate një numër 651/18/2551/511, sipas LPP-se numri 5 janë kontrata për pune e jo për shërbime te pastrimit te brendshëm. Komisioni gjithashtu ka analizuar edhe kushtet e përgjithshme te kësaj kontrate e cila është shkarkuar nga e-prokurimi ku qarte vërehet se kjo kontrate ka te beje me furnizime te ndryshme dhe pune ndërtimore e asgjë me shërbime te pastrimit.

Përgjigjja e OE ankuesit tek arsyeje nr. 2

Për te plotësuar këtë kërkesë siç e keni kërkuar ne Dosjen e tenderit: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), të lidhura me Institucionet Publike ose Private në vlerë prej jo më pak se 100,000.00 Euro. Ne kemi bashkangjitur dy referenca me Titull: "Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike ne qytetin e Lipjanit" dhe referencën tjetër "Mirëmbajtja dhe rregullimi I parqeve, hapësirave te gjelbëruara dhe shesheve, ne territorin e komunës se Obiliqit"

Ndërsa tek paramasa shkruan nr, rendor 2. Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave te jashtme dhe te gjelbëruara te UKZ, shtrohet pyetja se si nuk kemi mundur ta plotësojmë këtë kërkesë kur ju te njëjtën keni kërkuar ashtu siç edhe kemi sjelle referenca.

Eksperti Shqyrtues lidhur ne pretendimin e dytë sqaron, se në ofertën e GOE ankuesit "EL-Bau & Eing Com"SH.P.K janë të bashkangjitura tek oferta Lista e projekteve dhe po ashtu janë bashkangjitura edhe dy

referenca që përkojnë me Mirëmbajtje siç kërkohet në paramasën nr 2, gjerë sa OE ankuesi nuk ka bashkangjitur referenca të tjera në mënyrë që ta dëshmoj se I plotëson kriteret, andaj ky pretendim gjendet i pa bazuar.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATE/A:	25.02.2020
REFERENCE:	
PËR:	"EING COM" SH.P.K.
NGA:	Adem Duriqi, Drejtor i Prokurimit
LËNDA:	REFERENCË PËR PUNËT E KRYERA

Operatori Ekonomik: "EING COM" SH.P.K. nga Podujeva ka nënshkruar kontratë me Drejtorin e Prokurimit në Lipjan për kryerjen e punëve sipas kontratës me titull: "Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapsirave tjera publike në Qytetin e Lipjanit", me numër prokurimit: 613 016 034 221 të datës: 06.07.2016.

Çmimi total i kontratës së realizuar është: 89,935.31€ / 36 muaj

Departamenti i Prokurimit pran K. Lipjan-it konfirmon se punimet janë realizuar me sukses në cilësi dhe dinamikë, me këtë rast "EING COM" SH.P.K. ka treguar profesionalizëm të lartë dhe ka përbushur me përpunshmëri dhe korrektësi të gjitha kushtet e kontratës si në aspektin teknik dhe dinamik, andaj e rekomandojmë tek Autoritetet tjera Kontraktuese për shërbimet e realizimit të punimeve në projekte të ngjashme.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq



REFERENCE

Në bazë të kërkesës së EO: "EING COM", Durrës, Komuna Podujevë të datës: 17.02.2020 për kontratën dy vjeçare të lidhur me datë: 16.04.2018 në vlerë: 81,727,70€, me Nr.Prokurimit,OB610-18-1048-2-2-1,dhe me Nr. Kontrates XIII-42 të datës në mes të Komunës së Obiliqit dhe OE: "EING COM", Komuna e Obiliqit lëshon këtë referencë:

OE: "EING COM" me të cilën vërtetohet se kompania në fjalë ka bërë realizimin e projektit "Mirëmbajtja dhe rregullimi i parqeve, hapsirave të gjelbra dhe shesheve në territorin e Komunës së Obiliqit".

Vlera totale e shërbimeve të kryera: 106,657.84 € duke llogaritur edhe punët shtesë.

Kompania në fjalë ka zbatuar në përputhje të plotë kontratën sipas dinamikës kohore dhe sipas planit të paraparë në kontratë, prandaj si të tillë e rekomandojmë tek punëdhënësit e ardhshëm.

Menaxheri i Projektit
Bekim Kurtishi

Data
21.02.2020



Pretendimi i 3 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 3 e eliminimit të OE ankuesit:

• Oferta e juaj përmban dy çmime, një çmim ne formularin e paraqitjes se tenderit dhe një çmim ne analizën financiare, qe janë te ndryshme njëra me tjetrën. Përgjigjeje e OE ankuesit per arsyen nr.3 ,Nuk është e vërtet se oferta e jone përmban dy çmime sepse ne paramasën te cilën e kemi ofruar dhe formularin e tenderit kemi paraqitur çmimin prej 137,625.24 euro, ndërsa ne analizën financiare ne veç ju kemi treguar vetëm se si kemi ardhur deri te çmimi ofertues.

Eksperti shqyrtues sqaron se, ofertuesi në paramasën ku duhet të ceket çmimi final I ofertuesit është ai që merret si për bazë, ndërsa Ofertuesi në analizën financiare nuk ka dhënë çmimin e njëjtë, andaj Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e gjenë të pa bazuar.

Pretendimi i 4 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 4 e eliminimit të OE ankuesit:

• Ne analizën financiare për pozicionin numër 6 keni dhënë një sqarim qe shuma e

kalkuluar prej 9,735.99 € për pushimet vjetore nuk do t'i kalkulojen Autoritetit Kontraktues sepse kemi punëtorë me kontrata të tjera ne kompaninë tone dhe do te bëjmë zëvendësimin e tyre. Sipas RRUOP-se një gjë është e pa pranueshme sepse neni 41.15 pika 2 decidivisht thotë: “ Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet te refuzohet pasi qe dhuratat nuk janë te pranueshme”.

Përgjigjja e OE ankuesit për arsyen nr. 4: Gjate analizës financiare te cilën e kemi bere, zëvendësimet nuk i kemi kalkuluar fare sepse nuk është përgjegjësi e AK-se lidhur me zëvendësimet e punëtorëve sepse ne i paguajmë nga AK për njësi matëse për metër katror për pastrim, dhe nuk qëndron arsyeja se ne i kemi ofruar falas ndonjë artikull, por ky kalkulim i kompanisë tonë është ne favor te AK sepse ja kursen afër 10 mije euro AK, Shtrohet pyetja po ashtu UKZ nuk punon 365 dite, qe këto zëvendësimet te pushimeve vjetore bëhen ne harmoni me pushimet e Universitetit, ndërsa kujdestaria ne këtë periudhë është ne përgjegjësi tonën.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e katërt sqaron, se pretendimi I OE ankuesit gjendet i pa bazuar sepse ne Sepcifikime kërkohet të përmbushet pozicioni numër 6.

Pretendimi nr. 5 i OE ankues:

Arsyeja nr. 5 e eliminimit të OE ankuesit:

Arsyeja nr. 5

Nuk keni llogaritur ndërrimin e natës për një mirëmbajtës siç është kërkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kërkesa 2 pika e 3-te fq. 15, ku thotë se: orari i shërbimeve te mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin.

Përgjigje e OE ankues për arsyen nr. 5, më dt. 17.06.2020 nga AK kemi pranuar Njoftimin Ju njoftojmë se tek Ri tenderi- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik. Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika2." Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës. Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit. Shtrohet pyetja se si keni mundur te na eliminoni për këtë pike kur ju te njëjtën e keni larguar nga Specifikacioni teknik.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e pestë sqaron, se AK ka bërë gjetje tek kërkesa 2 pika 3“Orari i shërbimeve te mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin“ në Faqe 15, ndërsa OE ankuesi e ka shpjeguar pikën 4 në këtë pretendim, e cila nuk përkon me arsyetimin e eliminimit të AK-së.

Mirëpo Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se OE ankuesi në analizën financiare e ka lënë të hapur këtë pozicion, andaj Eksperti Shqyrtues pretendimin e gjen të pa bazuar.

2. Mirëmbajtja e rrjetit Elektrik: do të përfshijë të gjitha punët e nevojshme elektrike si p.sh. rregullimi i ndërprerësve dhe prizave të dëmtuara, zëvendësimi i ndërprerësve automatik të qarkut, poqas e elektrik, armaturave dhe gypave fluoreshent, trupave ndriçues të jashtëm dhe punë tjera të nevojshme elektrike. Gjithashtu është e vlefshme të përmendet se inspektimet duhet të bëhen në mënyrë që të identifikohen problemet/prishjet e mundshme dhe të bëhen mirëmbajtje preventive.

- Ofruesi duhet të sigurojë të gjithë personelin, pajisjet, materialin dhe kripën industriale për vlikrjetjen e botes.
- Ofruesi duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve dhe duhet të organizoj punën në atë mënyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprerë.
- Orari i shërbimeve të mirëmbajtjes është 24 orë në 7 ditë të javës për gjatë gjithë vitit.
- OE duhet të siguroj kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtjes) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiçan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

NJOFTIM PËR OPERATORËT EKONOMIK - PËR GABIM TEKNIK

Të nderuar,

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik.

Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtjes) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Ju faleminderit për mirëkuptim.

Me respekt
Zyra e Prokurimit
Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjiçan

Adan kohor për dorëzimin e tenderit - aplikacioneve të dorëzuar:	
Pa <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	
Nëse po, jep arsyetimin:	
Mëqenëse jemi në përfundim të kontratës aktuale e cila skadon në Shtator të 2020-tës, dhe për shkak vonesave të numdshme të procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës tjetër.	
Hapja e Tenderit	26.1
Hapja e tenderit do të bëhet me:	
19.06.2020 në 14:30:00 orë	
Vendi: Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Zyra e Prokurimit	
Përgjegjësi i tenderit dhe detyrat	29.3
Kritimet e Detyrës	30.1
Tendeni i përgjegjësit me Caktimin në të cilin <input checked="" type="checkbox"/>	
Ankimet	31.3
Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Zyra e Prokurimit	

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"

• Arsyet e eliminimit të ofertës sonë:

Arsyeja e parë : Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave Ka Konstatuar se oferta juaj është e pa përgjegjshme sepse, nuk e keni plotësuar Përshkrimin e çmimeve sipas sqarimeve të fundit të dosjes së tenderit, keni ofruar çmim mujor e jo çmim për 36 (muaj) siç është kërkuar tek përshkrimi i çmimeve sipas sqarimeve të fundit në dosjen e tenderit.

Përgjigja e OE ankuesit të arsyetimi i parë:

Lidhur me pikën e parë për shpalljen të papërgjegjshme të ofertës sonë shih kërkesa lidhur me vendosjen e çmimeve.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Çmimin për - njësi Pa	TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda	M2	6100 M2			
2	Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të	M2	6200 M2			
					Gjithsej	0

Total i Përgjithshëm mujor të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikës e Kosovës. Duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas analizës financiare.

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe analizimit të ofertës dhe kërkesave të AK-së, sqaron se OE ankues ka paraqitur përshkrimin e çmimeve sipas formës vjetër duke e kalkuluar çmimin mujor:



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEK" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Përshkrimi i çmimeve "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Çmimi për njësi Pa TVSH	TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan	M2	6100 M2	€ 0.51	18%	€ 3,660.00
2	Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan	M2	6200 M2	€ 0.03	18%	€ 248.00
					Gjithsej	€ 3,908.00

Totali i Përgjithshëm Mujor dhe të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikën e Kosovës
duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas analizës financiare.

Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se në kërkesën e AK-së lidhur me përshkrimin e çmimeve, AK ka paraqitur exelin e korigjuar më datën 15.06.202, ku kërkohet kalkulimi për 36 muaj, d.m.th komplet çmimi për 3 vite, ndërsa OE ankuesi I eliminuar ka paraqitur gabim:



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEK" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Përshkrimi i çmimeve "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Numri i muajve (36)	Sasia Totale për 3 vite	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi në total për 3 Vite
1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan	M2	6100 M2	36	219600		
2	Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan	M2	6200 M2	36	223200		
					Gjithsej		

Totali i Përgjithshëm Mujor dhe të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikën e Kosovës
duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas
analizës financiare.

Andaj pretendimi I OE ankuesit nuk është i bazuar.

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankuesit: Nuk keni llogaritur ndërrimin e natës për një punëtor siç është kërkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kërkesa 2 pika e 3-te fq. 15, ku thotë se "orari i shërbimeve të mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin"

Përgjigja e OE ankuesit për pretendimin e dytë: Lidhur me pikën e renditur 2 ku thuhet se nuk keni kalkuluar kërkesat e dosjes së tenderit për çështjet sociale të punëtorëve shih korrigjimin e autoritetit si dhe vendimin pjesë nga vendimi i OSHP-së që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

• Korrigjimi i dhënë nga autoriteti kontraktues

Të nderuar,

Ju njoftojmë se tek Ri tenderi-Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik. Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës". Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, se AK ka bërë gjetje tek kërkesa 2 pika 3 "Orari i shërbimeve të mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin" në Faqe 15, ndërsa OE ankuesi e ka shpjeguar pikën 4 në këtë pretendim, e cila nuk përkon me arsyetimin e eliminimit të AK-së. Andaj ky pretendim nuk gjendet i bazuar.

2. Mirëmbajtja e rrjetit Elektrik: Është përfshirë te gjitha punët e nevojshme elektrike si p.sh. tregullimi i ndërprerësve dhe prishjet të demtuara, zëvendësimi i ndërprerësve automatik të qarkut, pengave elektrik, armaturave dhe gypave fluoreshent, trupave ndriçues të jashtëm dhe punë tjera të nevojshme elektrike. Gjithashtu është e vlefshme te përmendet se inspektimet ditore dhe të bëhen në mënyrë që te identifikohen problemet/prishjet e mundshme dhe te bëhen mirëmbajtje paravente.

- Ofertuesi duhet të sigurojë te gjithë personelin, pajisjet, materialin dhe kripën industriale për shërbimet e kësaj.
- Ofertuesi duhet të sigurojë personelin të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve dhe duhet te organizoj punën ne atë mënyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprere.
- Orari i shërbimeve të mirëmbajtjes është 24 ore në 7 dite të javes për gjatë gjithë vitit.
- OE duhet te siguroj kujdestari per intervenime emergjente prej se paku 3 te punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrike, kanalizim dhe ujësjellës.

Arsyeja e tretë e eliminimit të OE ankuesit: Tek përshkrimi i ofertës, analiza financiare keni dhënë cmim 140,688.00€, ndërsa komisioni vlerësues ka konstatuar se çmimi është 142,179.00 €, ju si OE është dashur të llogaritni edhe TVSH për 3 pozicionet e tjera (Uniformat, Fitim të planifikuar dhe Material), ju TVSH-n e keni llogaritur vetëm në paga.

Përgjigja e OE ankuesit për pretendimin e tretë:

Arsyetimi i tretë i dhënë si ndryshim aritmetik më arsyetimin se nuk kemi kalkuluar TVSh sipas Ligjit mbi tatimin e shtuar. Nuk ka rregull ligjore që e rregullon çështjen e faturimit të TVSh në materialin higjienik, dhe në uniformat të punës sepse të dyja këto janë pagesa të cilat OE paguan palëve të treta në këtë rast si rregull TVSh është e rimbursueshme nga ATK.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, OE ankuesi ka paraqitur një përshkrim (Analizë Financiare), ku për uniformat nuk shkruan në Specifikacion DT që të llogaritet TVSH, gjerë sa tek materiali OE ankuesi e ka llogaritur TVSH-në:

4. Përgjegjësitë e përgjithshme

Ofertuesit janë të obliguar që të sigurojnë personelin punonjës, mbikëqyrjen, pajisjet, mjetet, materialin shpenzues për pastrim, kemikalet, transportin dhe gjesender tjera që janë të nevojshme për të kryer punët si kurse kërkohet në dokumentin e ofertës.

Gjithashtu ofertuesit duhet të jenë përgjegjës për sigurimin e materialit pastrues, furnizimeve tjera, agjenteve për pastrim, materialeve dhe mjeteve tjera të specializuara si dhe transportimin e tyre në mënyrë që të bëjnë ekzekutimin e punëve në mënyrë sa më profesionale.

Ofertuesit duhet të jenë përgjegjës për të gjitha uniformat dhe mbulesat e trupit, në vendet ku dhe si nevojiten duhet të furnizojnë uniforma mbrojtëse të cilat nuk do të kufizohen vetëm në, doreza, syze mbrojtëse, maska për fytyrë, çizme mbrojtëse për shpata si dhe helmata në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të standardeve evropiane për siguri dhe shëndet në punë.

Përshkrimi i çmimeve i Materialit për Pastrimin							
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Numri i muajve (36)	Sasia Totale për 3 vite	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi ne total për 3 Vite
1	Letër përshirë 2 ply për duar (rolle dy shtresore për aparate)	Copë	30	36	1080	0.68	734.4
2	Letër tualeti 2 ply	Kom.1/10	30	36	1080	1.27	1371.6
3	Dezinfectues (Domestos apo Ekuivalent)	Copë	30	36	1080	0.84	907.2
4	Acid Chlorhydroic (HCl)	Litër	20	36	720	0.42	302.4
5	Detergjent i lëngshëm Vim	Copë	10	36	360	0.55	198
6	Material standard për pastrimin e dyshemesë së rëndomtë	Litër	60	36	2160	0.31	669.6
7	Material standard për pastrimin e dyshemesë së tualetit	Litër	10	36	360	0.31	111.6
8	Material për pastrimin dhe dezinfektimin e dyshemeve në Klasa,Salla,Kabinete dhe Zyra	Litër	16	36	576	0.17	97.92
9	Detergjente të posaqme për shama të dritareve	Litër	30	36	1080	0.48	518.4
10	Kese për Mbeturina-Ngjyra e zezë-Mbeturina të zakonshme 120 L.	Kom. 1/10	35	36	1260	0.38	478.8
11	Kese për Mbeturina-Ngjyra e zezë-Mbeturina të zakonshme 60 L.	Kom.1/10	40	36	1440	0.42	604.8
12	Material për pastrimin e lavamanëve dhe rubinetëve me mjete zbardhuese dhe lustrim	Litër	6	36	216	0.66	142.56
13	Sapun për duar i lëngshëm	Litër	20	36	720	0.39	280.8
14	Air fresh sprej 0.5 L.	Copë	12	36	432	0.75	324
15	Air fresh për tualete	Copë	12	36	432	0.75	324
16	Aparata për letër me sensor (25 cm)	Copë	12	1	12	0.15	1.8
17	Aparata për terfen e duarve me sensor	Copë	12	1	12	0.15	1.8
		Totali i materialit për pastrim					7,069.68

Nga: Kompania e Pastrimit "Efa Dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë" me numer të biznesit 810804999 me address: Rr. "Rexhep Mala" Aktash .Nr.25 Prishtinë.

Për: UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

Lënda: ANALIZË FINANCIARE

Data: 19.06.2020

Nr.	Paga Bazë	Trusti 5 %	Pushimi vjetor	Uniforma
1	290.00	101.50	169.17	3.50
2	360.00	18.00	30.00	0.50
3	360.00	18.00	30.00	0.50
4	2,750.00	137.50	239.17	
5	99,000.00	4,950.00	8,250.12	162.00

Përshkrimi i ofertes	
Pagat total	€ 112,200.12
TVSH	€ 20,196.02
Uniformat	€ 162.00
Fitimi i planifikuar	€ 1,080.18
Materiali	€ 7,069.68
totali	€ 140,688.00

Administrata e Kompanisë



Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankues e gjene pjesërisht bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankuesve të lartpërmendur të aprovohen pjesërisht, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 20.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 21.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik Efa Grup "Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë" me datë 26.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Për: Organin Shqyrtues të Prokurimit

Nga: "efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"

Lënda: Përgjigjeje në ekspertizë nr 738 747/20

Të nderuar

Ne pasi kemi pranuar përgjigjen në ekspertizë, ekspertja përveç se ka përshkruar tekstin në ankesën tonë dhe arsyet e eliminimit nga ana e AK-së.

NE NUK PAJTOEHMI ME MENDIMIN E EKSPERTIT për arsyet e poshtë shënuara.

Ne kemi dhënë sqarimet tona të cilat janë të bazuara në DT dhe sqarime të dosjes së tenderit ku edhe vetë AK ka sqaruar.

Sa i përket formularit të çmimit se nuk e kemi plotësuar për 3 vite por vetëm për një muaj edhe sikur të jetë ashtu çmimi i dhënë për një muaj * 36 muaj jep vlerën e saktë për 3 vite dhe nuk përmban ndonjë ndryshim në aspektin material dhe nuk ka pasur as vërejtje në hapjen e tenderit dhe as në raportin e vlerësimit.

Sa i përket çështjes së dytë AK ka dërguar një korrigjim ku ka cekur:

Korrigjimi i dhënë nga autoriteti kontraktues

Të nderuar,

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik. Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Edhe pse kjo pjesë ka qenë para publimit të DT të re sepse me datë 15.06.2020 AK ka ngarkuar një DT të re ku ka cekur specifikime të reja dhe ka hjekur pretendimin e cekur në arsyen për eliminim.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Informatë me rëndësi:

Duhet të jeni në dijeni se Autoriteti Kontraktues e rezervon të drejtën ligjore për verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara dhe të kërkojë sqarime shtesë dhe verifikime nga çdo ofertues apo autoritet publik i cili i lëshon këto dokumente që kanë të bëjnë me informata para dhënies së kontratës.

Çdo material ose pajisje që është e cekur me emër ose është cekur prodhuesi, ai material ose pajisje mundet me qenë edhe ekuivalente, me specifika të njëjta ose më të mira.

Po ashtu ju njoftojmë se kalkulimi i Çmimeve të materialit higjienik do të bëhet në bazë të çmimeve referente të cilat gjenden në ueb faqen e KRPP-së.

VËREJTJE:

OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analizë do të përfshijë:

Pagat bruto për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, sipas specifikacionit në dosje të tenderit.

Pagat e përgjegjësve dhe të menaxherit kryesor sipas specifikacionit në dosje të tenderit.

Vlerën e materialit shpenzues për pastrim sipas specifikacionit në dosje të tenderit.

Vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosje të tenderit.

Pagesat e ndërrimeve të natës për mirëmbajtësit sipas specifikacionit në dosje të tenderit.

Zëvendësimet e punëtorëve me rastin e pushimeve vjetore.

Vlerën e pajisjeve dhe instalimin e tyre në hapësirat e UKZ-së

Çmimi jo normalisht i ulët i vlerësuar sipas analizës financiare e bënë tenderit të papërgjegjshëm sipas Nenit 61 të LPP-së.

Pra edhe në DT të korigjuar sipas datave

26.05.2020 / 15.06.2020

Janë kërkuar të respektohen këto vërejtjet e lartcekura sipas ANEKS 1 në DT ku edhe vetë kërkesat e AK kanë qenë tepër të qarta.

AK ka cekur qartë se është hequr pika 2 e cila përmban 3 nën pika:

Si më poshtë

2. **Mirëmbajtja e rrjetit Elektrik:** do të përfshijë të gjitha punët e nevojshme elektrike si p.sh. rregullimi i ndërprerësve dhe prizave të dëmtuara, zëvendësimi i ndërprerësve automatik të qarkut, poqave elektrik, armaturave dhe gypave fluoreshent, trupave ndriçues të jashtëm dhe pune tjera të nevojshme elektrike. Gjithashtu është e vlefshme të përmendet se inspektimet ditore do të behet në mënyrë që të identifikohen problemet/prishjet e mundshme dhe të behet mirëmbajtje preventive.

- Ofertuesi duhet të sigurojë të gjithë personelin, pajisjet, materialin dhe kripten industriale për shkrirjen e bores.
- Ofertuesi duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve dhe duhet të organizoj punën në atë mënyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprere.
- Orari i shërbimeve të mirëmbajtjes është 24 orë në 7 ditë të javës për gjatë gjithë vitit.
- OE duhet të sigurojë kujdestari për intervenime emergjente prej se paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

Kurse pika 3 sipas ekspertit e cila e ka përgënjeshtuar thotë se

punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

3. **Sherbimet e Kopshtarisë:** Kjo njesi do të kryejë të gjitha punët e kopshtarisë dhe shërbimeve të përgjithshme sikur që janë

- Pastrimi i të gjitha hyrjeve dhe trotuereve dhe hapsirave të parkingut
- Pastrimi i dehoes gjatë sezonit të dimrit në baza ditore
- Mirëmbajtja e hapsirave të gjelbërta si Psh prerja e rregullt e vegjetacionit, mirëmbajtja e rregullt e vendkalimeve, krasitja e degeve, mbjellja e luleve dhe fidaneve të reja, dezinfektimi i drunjeve.

Tani le të mbetët në ndërgjegjen e juaj se si duhet të veprohet sipas këtyre fakteve pasi që të gjitha provat flasin qartë se nuk kemi bërë ndonjë gabim të pariparueshëm.

Paneli i nderuar duke shprehur konsideratën tonë për ju por edhe duke mos dashur të nënvlerësojnë vetën tonë në njohurit andaj ju lusim për drejtësi duke shqyrtuar secilin pretendim ankimor tonin por edhe provat e ofruara duke na mbrojtur nga padrejtësitë.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "El-Bau & Eing Com" SH.P.K., se AK e ka eliminuar me arsyetimin se i mungon ISO Certifikata OHSAS 18001-2007, për veprimtarinë adekuate siç është kërkuar në dosjen e tenderit për siguri dhe pastrim të hapësirave të brendshme, ku AK ka konstatuar se OE ankues ka prezantuar ISO OHSAS 18001-2007 për ndërtim të lartë dhe të ulët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ofertën e grupit të operatorëve ekonomik ankues "EL-Bau & Eing Com" SH.P.K janë të bashkangjitura tek oferta certifikatat, ku OE ka sqaruar se certifikata OHSAS 18001:2007 është zëvendësuar me ISO 45001:2008. Po ashtu, në E-prokurim edhe disa OE të tjerë kanë dhënë shpjegime për këtë certifikatë. Mirëpo, Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur që të verifikojë këtë certifikatë nëse OE ankues e plotëson kërkesën e AK-së.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "El-Bau & Eing Com" SH.P.K., se në aspektin tekniko-profesional është kërkuar nga AK se OE pjesëmarrës në këtë tender duhet të ofroj kontrata të natyrës së ngjashme, kurse

OE ankues në ofertë ka prezantuar një kontratë një numër 651/18/2551/511, sipas LPP-së numri 5 janë kontrata për punë e jo për shërbime të pastrimit të brendshëm. Komisioni gjithashtu ka analizuar edhe kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate e cila është shkarkuar nga e-prokurimi, ku qartë vërehet se kjo kontratë ka të bëjë me furnizime të ndryshme dhe punë ndërtimore e asgjë me shërbime të pastrimit.

Për te plotësuar këtë kërkesë siç është kërkuar në dosjen e tenderit: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), të lidhura me Institucionet Publike ose Private në vlerë prej jo më pak se 100,000.00 Euro. Ne kemi bashkangjitur dy referenca me Titull: “Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike ne qytetin e Lipjanit” dhe referencën tjetër "Mirëmbajtja dhe rregullimi I parqeve, hapësirave te gjelbëruara dhe shesheve, ne territorin e komunës se Obiliqit”. Ndërsa tek paramasa shkruan nr, rendor 2. Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave te jashtme dhe te gjelbëruara te UKZ, shtrohet pyetja se si nuk kemi mundur ta plotësojmë këtë kërkesë kur ju te njëjtën keni kërkuar ashtu siç edhe kemi sjelle referenca.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ofertën e grupit të operatorëve ekonomik ankues “EL-Bau & Eing Com” SH.P.K janë të bashkangjitura tek oferta Lista e projekteve dhe po ashtu janë bashkangjitura edhe dy referenca që përkojnë me Mirëmbajtje siç kërkohet në paramasën nr. 2, ndërsa OE ankues nuk ka bashkangjitur referenca të tjera në mënyrë që ta dëshmoj se i plotëson kriteret. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Në lidhje me pretendimin e tretë ankimor të OE ankues “El-Bau & Eing Com” SH.P.K., se AK e ka eliminuar me arsyetimin se oferta përmban dy çmime, një çmim në formularin e paraqitjes se tenderit dhe një çmim në analizën financiare, që janë të ndryshme njëra me tjetrën.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues në para masën ku duhet të ceket çmimi final i ofertuesit është ai që merret për bazë. Ndërsa, ofertuesi në analizën financiare nuk ka dhënë çmimin e njëjtë. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Kurse, sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “El-Bau & Eing Com” SH.P.K., se AK ka konstatuar se në analizën financiare për pozicionin numër 6 keni dhënë një sqarim që shuma e kalkuluar prej 9,735.99€ për pushimet vjetore nuk do t’i kalkulohe autoritetit kontraktues sepse kemi punëtorë me kontrata të tjera në kompaninë tonë dhe do të bëjmë zëvendësimin e tyre. Sipas RRUOP-se një gjë është e pa pranueshme sepse neni 41.15 pika 2 decidivisht thotë: “ Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në specifikime kërkohet që të përmbushet pozicioni numër 6. Pra, pretendimi është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “El-Bau & Eing Com” SH.P.K., se AK ka konstatuar se OE nuk ka llogaritur ndërrimin e natës për një mirëmbajtës siç është kërkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kërkesa 2 pika e 3-te fq. 15, ku thotë se: orari i shërbimeve te mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka bërë gjetje tek kërkesa 2 pika 3 “Orari i shërbimeve te mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin” në faqe 15, ndërsa OE ankues e ka shpjeguar pikën 4 në këtë pretendim, e cila nuk përkon me arsyetimin e eliminimit të AK-së. Mirëpo, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues në analizën financiare e ka lënë të hapur këtë pozicion, andaj pretendimi është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë”, se AK e ka eliminuar me arsyetimin: oferta juaj është e pa përgjegjshme sepse nuk e keni plotësuar përshkrimin e çmimeve sipas sqarimeve të fundit të dosjes së tenderit, keni ofruar çmim mujor e jo çmim për 36 (muaj) siç është kërkuar tek përshkrimi i çmimeve sipas sqarimeve te fundit ne dosjen e tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas verifikimit dhe analizimit të ofertës dhe kërkesave të AK-së, sqaron se OE ankues ka paraqitur përshkrimin e çmimeve sipas formës së vjetër duke e kalkuluar çmimin mujor, ku eksperti i ka bashkangjitur tabelën e përshkrimit të çmimeve. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në kërkesën e AK-së lidhur me përshkrimin e çmimeve, AK ka paraqitur exelin e korrigjuar më datën 15.06.202, ku kërkohet kalkulimi për 36 muaj, d.m.th komplet çmimi për 3 vite, ndërsa OE ankuesi i eliminuar ka paraqitur gabim. Pra, pretendimi i OE ankuesit është i pa bazuar.

Në lidhje me arsyen e dytë të eliminimit të OE ankues “Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë”, se nuk ka llogaritur ndërrimin e natës për një punëtor siç është kërkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kërkesa 2 pika e 3-te fq. 15, ku thotë se “orari i shërbimeve te mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka bërë gjetje tek kërkesa 2 pika 3 “Orari i shërbimeve te mirëmbajtjes është 24 ore 7 dite ne jave për te gjithë vitin” në faqe 15, ndërsa OE ankues e ka shpjeguar pikën 4 në këtë pretendim, e cila nuk përkon me arsyetimin e eliminimit të AK-së. Andaj ky pretendim nuk është i bazuar.

Lidhur me arsyen e tretë të eliminimit të OE ankues “Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë”, se tek përshkrimi i ofertës, analiza financiare ka dhënë çmimin 140,688.00€, ndërsa komisioni vlerësues ka konstatuar se çmimi është 142,179.00 €, ju si OE është dashur të llogaritni edhe TVSH për 3 pozicionet e tjera (Uniformat, Fitim të planifikuar dhe Material), ju TVSH-n e keni llogaritur vetëm në paga.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një përshkrim (Analizë Financiare), ku për uniformat nuk shkruan në Specifikacion e dosjes së tenderit që të llogaritet TVSH, ndërsa tek materiali OE ankues e ka llogaritur TVSH-në, ku eksperti ka bashkangjitur kërkesën e AK dhe tabelën e përshkrimit të çmimeve të materialit për pastrim. Andaj, ku pretendim është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK në përgjithësi ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përjashtimisht me disa devijime të vogla të cilat nuk paraqesin ndryshime materiale sepse edhe po të kthehej në rivlerësim ky aktivitet i prokurimit për sqarime shtesë në raport me OE ankues, përsëri tenderët e këtyre operatorëve ekonomik ankues do të rezultonin si të pa përgjegjshëm. Andaj, Paneli Shqyrton vlerëson se AK nuk ka diskriminuar apo nuk ka vlerësuar tenderët në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Universiteti publik Kadri Zeka";
- 1x1 OE "El-Bau & Eing Com" SH.P.K;
- 1x1 OE "Efa Dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë";
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.